

## Emrat në gjuhën serbe

Emrat e serbëve që e kanë humbur jetën dhe janë zhdukur në mënyrë të dhunshme i shkruajmë në mënyrë autentike dhe në vetën e parë, ndërkaq ato lakohen duke i kombinuar të dy gjuhët për të ruajtur sa më shumë të jetë e mundur emrin autentik. Në këtë mënyrë është ruajtur rrënja e emrave serbe edhe gjatë lakimit sipas standardeve të gjuhës shqipe. Për sa u përket emërtimeve të vendbanimeve, e kemi aplikuar rregullën tani standarde e shumëvjeçare të FDH-së – i shkruajmë në dy gjuhë, së pari në shqip, e pastaj në serbisht gjithnjë në vetën e parë.

## Mirënjohje për hulumtuesit dhe analistët

Energjia dhe përkushtimi i Sandra Orlovićit dhe Bekim Blakajt në hartimin e *Libër Kujtimit të Kosovës, Viti 1998*, është unik. Bekimi e udhëhiqte ekipin e madh të hulumtuesve, ndërkaq Sandra e përbënte urën ndërmjet hulumtuesve dhe analistëve. Që të dy i dinë përmendësh emrat e të gjithë njerëzve që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur me dhunë në Kosovë. Këtë punë nuk kanë mundur ta bëjnë pa hulumtuesit dhe analistët, nga të cilët secili individualisht e ka dhënë kontributin e vet profesional dhe njerëzor. Deklaratat e para për vrasjet, rrëmbimet dhe zhdukjet e vitit 1998 e mbajnë autorësinë e hulumtuesve Nora Ahmetaj, Ariana Zherka, Vjollca Musliu, Marijana Anđelković dhe Snežana Orlović. Gordana Igrić e udhëhiqte projektin e hulumtimit në vitin 1998. Aty pranë gjendej edhe Bogdan Ivanišević, i saktë si në përpilimin e deklaratave ashtu edhe në analizë. FDH u kthehet ngjarjeve të vitit 1998 disa vite më vonë, me idenë e qartë për hartimin e *Libër Kujtimit të Kosovës*. Ka pasuar hulumtimi shumëvjeçar i rasteve të krimeve të luftës, vrasjeve dhe zhdukjeve të dhunshme pas lufte, deri në vitin 2000. Përveç Kosovare Kelmendit, mirënjohja u takon edhe hulumtuesve të FDH-së dhe FDH Kosovës: Agron Lloçuni, Aleksandar Glišić, Anita Varajić, Arijeta Spahiu, Bashkim Hisari, Besnik Krasniqi, Bojan Tepavčević, Dragan Piletić, Gojko Pantović, Gordana Damjanović, Iskender Muzbeg, Laza Lazarević, Ljiljana Hellman, Milan Gačanović, Milijan Novaković, Mirjana Lazić, Olivera Budimir, Predrag Miletić, Sabina Hasanaj, Sandra Horina, Shpresim Arifi, Shqipe Gashi, Stana Tadić, Tamara Okmažić, si dhe bashkëpunëtorëve: Ardijana Ukella, Artër Buçaj, Dardan Shala, Debatik Doli, Dorina Ballata, Ibish Hoti, Kujtim Gacaferi, Labinot Krasniqi, Mustafë Radoniqi, Pal Bala, Rushit Velu, Sherif Aliaj, Shkëlzen Gashi, Shpresa Veliqi, Teki Bokshi, Violeta Kelmendi, Vjollca Bejtullahu dhe Xhevdet Rushiti.

## Mirënjohje shoqatave dhe familjeve të viktimave

Në Kosovë na kanë ndihmuar më së shumti familjet e viktimave, jo vetëm përmes deklaratave për anëtarë të vet që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur në mënyrë të dhunshme, por edhe përmes njohurive dhe kontakteve të tyre me familje të tjera dhe dëshmitarë potencial. Na kanë ndihmuar edhe komunitat e Deçanit/Deçani, Glllogocit/Glogovac, Gjilanit/Gnjilane, Istogut/Istok, Kaçanikut/Kaçanik, Klinës/Klina, Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Lipjanit/Lipljan, Malishevës/Mališevo, Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, Prishtinës/Priština, Prokuples, Obiliqit/Obilić, Rahovecit/Orahovac, Pejës/Peć, Podujevës/Podujevo, Prizrenit/Prizren, Skënderajt/Srbica, Suharekës/Suva Reka, Shtimes/Štimlje, Ferizajt/Uroševac, Vushtrrisë/Vu-